



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 832 / 15 prot.

Vlorë, më 14 .05 .2021

VENDIM

Nr. 23, datë 12. 05. 2021

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT MASTER PROFESIONAL NË
MËSUESI NË HISTORI- GJEOGRAFI,
APLIKUAR PËR VITIN AKADEMIK 2021- 2022**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, shkronja dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemalli", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës, 12. 05. 2021

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e programit "**Master Profesional**" në "**Mësuesi në Histori-Gjeografi**", aplikuar për vitin akademik 2021- 2022 (sipas rregullores bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

Programi i studimit "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi" ofrohet nga Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të dytë, "Master Profesional" në mësimdhënie Histori-Gjeografi, i cili ofrohet në dy vite akademike, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 120 kredite (ECTS) dhe merr diplomën universitare: "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi".

Neni 2

Objektivat formues të programit

Programi synon të përgatisë mësimdhënësit të specializuar, të aftë që të punojnë në Arsimin e Mesëm të Ulët dhe të Lartë, në sektorin publik dhe privat duke ju përgjigjur kërkesave të sotme të shkollës. Duke ndjekur zhvillimet në kuadrin evropian në vend dhe më gjerë, në përgatitjen e këtij programi janë pasur parasysh udhëzimet dhe profili i mësimdhënësit dhe mësimdhënies në degën Histori-Gjeografi. Programi synon të jetë një program i përgjithshëm mësimdhënieje, ndërdisiplinor, me specializime në fusha përkatëse të mësimdhënies sipas nevojave dhe zgjedhjeve të studentëve, në përfundim të të cilit studenti do të jetë i aftë t'i konceptojë studimet në fushën e mësimdhënies së Histori-Gjeografisë si disiplina akademike me kontekst të gjerë historik, shkencor, gjeografik, ndërkulturor dhe ndërdisiplinor. Ky program do e pajis studentin me:

Kompetenca të aftësimit vetjak dhe të nxënës të pavarur


Nënkupton aftësinë për të organizuar aktivitete studimore dhe profesionale në mënyrë të pavarur, për të zbatuar shprehje praktike dhe hulumtuese.

Kompetenca shoqërore dhe komunikuese

Nënkupton aftësinë për të kuptuar ndikimin që dallimet kulturore kanë në ndërveprimet shoqërore dhe për të komunikuar, ndërvepruar dhe bashkëpunuar me sukses në një mjedis shumëkulturor.

Nënkupton aftësinë për të kryer punë në grup/skuader duke marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Kompetenca të organizimit dhe seleksionimit të informacionit

Nënkupton aftësinë për të punuar me burime të ndryshme informacioni, për të vlerësuar dhe përzgjedhur në mënyrë kritike, si dhe për të përdorur në mënyrë praktike informacionin që lidhet me fushën e studimit, por jo vetëm.

Kompetenca të fushës/profesionale

Kompetenca të përgjithshme historiko-geografike

Nënkupton njohuri bazë të studimit të programit që lidhen me elementet dhe konceptet historiko-geografike funksionet e tyre, përdorimet në mësimdhënie.

Nënkupton aftësinë për të mbledhur të dhëna historike e geografike me qëllim kryerjen e studimeve dhe analizave duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore.

Kompetenca në metodologji dhe didaktikë të mësimdhënies

Nënkupton njohuri rreth këtyre fushave dhe zhvillimit të tyre në mësimdhënien e histori-geografisë.

Nënkupton aftësinë për të zbatuar qasjet, metodat dhe teknikat më bashkohore, më efikase në varësi të grupmoshave, qëllimeve dhe nevojave specifike të nxënësit.

Nënkupton aftësinë për të mbledhur të dhëna mbi situata të ndryshme gjatë mësimdhënies e mësimnxënies me qëllim kryerjen e studimeve dhe analizave duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore.

Nënkupton aftësinë për të përdorur teknologjinë dhe mundësitë që ofron ajo gjatë mësimdhënies e mësimnxënies.

Kompetenca letrare dhe kulturore

Nënkupton njohuri rreth gjuhësisë, kulturës, historisë dhe geografisë, si dhe vendin e rolin e tyre në një kontekst më evropian dhe global.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

Kurrikula e programit të studimit "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi" organizohet në:

- Lëndë bazë-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme
- Lëndë karakterizuese-përgatitje për disiplinën shkencore
- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese-nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje
- Lëndë plotësuese-gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale
- Detyrime përmbyllëse- Provim përfundimtar/Punim diplome

Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "GEO"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

dhe "HIS" lëndë të natyrës gjeografi dhe histori, me EDU lëndë të karakterit psiko-pedagogjik etj. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar etj., paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

- Disiplina e formimit të përgjithshëm -12 kredite.
- Disiplina të formimit karakterizues - 40 kredite.
- Disiplina e lëndëve integruese/ndërdisciplinore - 36 kredite.
- Disiplina të formimit plotësues -12 kredite.
- Detyrime përmbyllëse – 20 kredite

Disiplina të formimit të përgjithshëm
(12 kredite)

- | | |
|--|-----------|
| 1. EDU 444- Metodologji e Mësimdhënies dhe të nxënit | 4 kredite |
| 2. EDU 441-Bazat pedagogjike të Edukimit | 4 kredite |
| 3. EDU 450-Bazat e psikologjisë së Edukimit | 4 kredite |

Disiplina të formimit karakterizues
(40 kredite)

- | | |
|--|-----------|
| 4. GEO 455-Trashëgimi natyrore dhe kulturore
<i>Mod. I. Trashëgimia natyrore</i>
<i>Mod. II. Trashëgimia kulturore</i> | 6 kredite |
| 5. HIS 585-Kërkim shkencor në histori | 6 kredite |
| 6. GEO 586-Kërkim shkencor në gjeografi | 6 kredite |
| 7. EDU 470-Metodat e Kërkimit në Edukim | 5 kredite |
| 8. HIS 476-Metodat e mësimdhënies së historisë | 6 kredite |
| 9. GEO 474-Metodat e mësimdhënies së gjeografisë | 6 kredite |
| 10. HIS 480-Edukim i të drejtave të njeriut | 5 kredite |

Disiplina e lëndëve ndërdisciplinore/integruese
(36 kredite)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

11. HIS 472-Histori e Institucioneve	5 kredite	
12. HIS 571-Histori e qytetërimit perëndimor në shkollë		5 kredite
13. HIS 520-Histori e arsimit dhe kulturës shqiptare		4 kredite
14. HIS 481/GEO 481 (Z)-Edukim qytetar/Edukim mjedisor		4 kredite
15. HIS 500/GEO 500 (Z)-Edukim evropian/Planifikim dhe rregullim i territorit	4 kredite	
16. ALB 500-Kulturë gjuhësore		4 kredite
17. GEO 472-Elemente të hartagrafisë dhe njohuri në GIS		5 kredite
18. GEO 530-Gjeografi e zhvillimeve demo-socio-ek. në hapësirën shqiptare		5 kredite

Disiplina të formimit plotësues
(12 kredite)

17. ENGH/ITAH 432-Gjuhë angleze e avancuar/Italisht	3 kredite
18. CSH 530-Komunikim dhe teknologji informacioni në edukim	3 kredite
19. HIS/GEO-586 Praktikë Profesionale	6 kredite

Detyrime përmbyllëse
(20 kredite)

20. HIS/GEO 590-Provim përfundimtar/Punim diplome	20 kredite
---	------------

Neni 4

Format dhe organizimi i studimit të programit "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi"

Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj.).

Neni 5

Format e kontrollit të dijes

Programi mësimor "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi" parashikon vlerësime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit.

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomave.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

a) me shkrim,

b) me gojë,

c) i kombinuar, me shkrim e me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 6

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 7

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Kontrolli i njohurive bëhet thjesht me një provim final, ose me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 8

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Edukimit. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit.

Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.

Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 9

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.

Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Neni 10

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: ese ose kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster.

Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 11

Vlerësimi për diplomim

Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome.

Studenti mesatarja e përgjithshme e të cilit është 8.5 (vlerësimet e marra në semestrin e parë), i njihet e drejta të realizojë punim diplome.

Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë studime individuale,
- Të jenë studime deskriptive apo analitike.
- Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura,
- Të ndjekin rregullat e shpallura nga DE për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016, si dhe Rregulloren e punimeve të miratuar nga DE.

Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim apo me gojë.

Neni 12

Modalitetet për dhënien e diplomës

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve në programin "Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi" janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:

- e formimit bazë
- karakterizues
- ndërdisiplinore/integruese
- plotësuese

2. Studenti duhet të ketë vlerësim "kalues" në provimin e formimit/punimin e diplomës.

4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 120 ECTS (kredite).

5. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mësimore të Departamentit të Edukimit për të kryer procedurat përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Neni 13

Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrashimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrashimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.
3. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
4. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike duke përfshirë modifikimin e skedarëve kompjuterike të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë të një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

NENI 14

Kushtet e pranimit

Kriteri hyrës në këtë program është zotërimi i një diplome të nivelit 6 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit ose çdo diplomë e huaj ekuivalente me të, programe këto të natyrës histori-geografi së bashku apo të veçanta.

Neni 15

Dispozita të veçanta

Departamenti i Edukimit dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

Përgjegjësi Departamentit
PhD. Ilva LAMAJ

